



Vllaznia do ta shfrytëzojë ndërprerjen e kampionatit për të zhvilluar një ndeshje miqësore përballë Ades. Pushimi i aktivitetit për ekipin shkodran duket se ka mbërritur në momentin më të mirë të mundshëm. Dy humbjet e njëpasnjëshme me Skenderbeun dhe Teuten kanë bërë që situata të mos jetë shumë entuziaste dhe stafi drejtues po mundohet të gjejë fajtoret për këto dy humbje. Analizat dhe diskutimet vazhdojnë por sigurisht që duhet punuar edhe për korrigjimin e gabimeve të vërejtura deri më tani. Për këtë arsye, ditën e shtunë është vendosur që të zhvillohet një ndeshje miqësore. Kundërshtar i Vllaznise në këtë miqësore do të jetë Ada e Velipojes. Trajneret Canaj dhe Shaba kanë rënë dakord për zhvillimin e kësaj miqësoreje ditën e shtunë.